

## Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin **Sekretare të Administratorit** një kandidat profesionist, i/e cila duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

### Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none"><li>Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë.</li></ul>
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none"><li>Të paktën 15 vite eksperiencë pune përkatëse në Sektorin Publik ose Privat.</li></ul>
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none"><li>Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.</li><li>Njohuri të mira administrative.</li><li>Njohuri shumë të mira të Legjislacionit për shoqëritë Tregtare.</li><li>Aftësi të mira personale për të komunikuar dhe menaxhuar mirë të gjitha nivelet e strukturave të Shoqërisë dhe aftësi të mira për të komunikuar me stafin në mënyrë të shpejtë dhe profesionale.</li><li>Aftësi të mira krijuese dhe në zgjidhjen e problemeve; Aftësi për të vendosur objektiva dhe për të marrë vendime bazuar në analiza korrekte, në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin financiar.</li><li>Aftësi për të planifikuar, menaxhuar, ndjekjen e detyrave dhe komunikimi në të gjitha nivelet e Shoqërisë;</li><li>Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme dhe profesionale;</li><li>Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e kërkuara.</li><li>Nivel i lartë integriteti dhe besueshmërie me një ndjenjë të fortë efikasiteti dhe orientimi të rezultateve;</li><li>Aftësitë kompjuterike janë thelbësore.</li></ul>

Kandidatët që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. ose në adresën [bnj@albpetro.al](mailto:bnj@albpetro.al)

Kërkesat pranohen deri më datën 05.10.2020, ora 16:00.

Personat e përzgjedhur do të kontaktohen nga shoqëria Albpetrol sh.a.